



Sipas të dhënave më të reja në Maqedoni ka rreth 300 000 pensionistë, prej të cilëve 188 600 janë shfrytëzues të pensionit të pleqërisë ose 62 për qind, 76 200 të atyre familjare ose 25 për qind dhe 12 për qind gjegjësisht 37 600 janë pensionistë invalidor

LSHPM me marrëveshje për veprimtari të përbashkët

## Mesatarisht 1,9 të punësuar mbulojnë një pensionist

Mesatarisht 1,9 të punësuar mbulojnë një pensionist, ndërsa për qëndrueshmëri të tërë sistemit vlerësohet se ky relacion duhet të jetë 3:1. Për ne pensionistët gjithësi është shqetësues edhe e dhëna për rritjen e vdekshmërisë gjatë vitit të kaluar, ndërsa posaçërisht në tre muajt e parë të vitit, për çka paraqitet mungesë e mjeteve në Fondin solidar dhe pagesa pas vdekjes vonohet nga dy-tre muaj, tha kryetari Argirovski



përshëndeti të pranishmit dhe shprehi kënaqësinë nga takimi. "Sot jemi këtu të merremi vesh se si do të veprojme në vitin 2017. Sipas të dhënave më të reja në Maqedoni ka rreth 300 000 pensionistë, prej të cilëve 188 600 janë shfrytëzues të pensionit të pleqërisë ose 62 për qind, 76 200 të atyre familjare ose 25 për qind dhe 12 për qind gjegjësisht 37 600 janë pensionistë invalidor. Në LSHPM janë anëtarësuar rreth 253 000 anëtarë, ndërsa rreth 36 000 janë në të tria lidhjet e pensioneve invalidore. Mbi 12 000 shfrytëzues të pensionit nuk janë anëtarë të asnjë lidhjeje, ndërsa në mesin e tyre janë edhe disa mijëra fëmijë të prindërve të vdekur. Siç e keni të njohur, sistemi pensional i Maqedonisë bazohet në solidaritet të gjeneratave, gjegjësisht të punësuarit paguan kontribute për pagesë të pensioneve. Mesatarisht 1,9 të punësuar mbulojnë një pensionist, ndërsa për qëndrueshmëri të tërë sistemit vlerësohet se ky relacion duhet të jetë 3:1. Për ne pensionistët gjithësi

është shqetësues edhe e dhëna për rritjen e vdekshmërisë gjatë vitit të kaluar, ndërsa posaçërisht në tre muajt e parë të vitit, për çka paraqitet mungesë e mjeteve në Fondin solidar dhe pagesa pas vdekjes vonohet nga dy-tre muaj. Për shkak të asaj Këshilli i organizatës së regjistruar për ndihmë solidarë dhe anëtarësim ka bërë analizë për mbijetesë në bashkëpunim me Ministrinë e punës dhe politikës sociale dhe FSPIM dhe solli konkluzion që të ndërmerren masa të parakohshme për gjashtë muajt e ardhshëm. Për atë qëllim propozohet mjetet për Fondin solidar të rriten prej 120 në 130 denarë. Me atë ky problem i madh aktual do të zgjidhet pa u penguar ose ulur detyrat tona programore.

Duke patur parasysh faktin se ne jemi një tërësi, shoqatat të cilat nuk i kanë harmonizuar statutet duhet ta bëjnë atë sa më shpejtë, ndërsa ndihet nevoja edhe për përforcimin e informimit interaktiv me informacione kthyese. Në këtë kohë, në mënyrë të theksuar është rritur edhe plaçkitja dhe sulmet

ndaj personave të vetëm të moshuar dhe dhunës familjare për çka planifikohet LSHPM dhe shoqatat të përgatisin strategji të përbashkët për bashkëpunim me policinë, për edukim të anëtarësimit, por edhe për përforcim të zgjimit të pjesëtarëve të SPB dhe strukturave tjera relevante. Nuk do të mungojë edhe çështja e pronësisë së shtëpive të pensionistëve, ulja e mëturjes dhe çmimeve të barërave, lirimit nga participimi për shërim në spitale dhe të tjera. Sikurse deri tani edhe në të ardhmen, LSHPM çdoherë punon në harmoni me ligjet e Maqedonisë dhe me misionin e saj kontribuon në realizimin e jetës më të mirë të të gjithë shfrytëzuesve të pensioneve, dhe me atë edhe për familjet e tyre. Me përvojën dhe maturinë tonë me përgjegjësi të madhe ndaj punës duhet të bashku të kontribuojmë që detyrat programore të realizojmë me kualitet të ri, paqe dhe masivitet dhe futje të noviteteve në veprime", është shprehur Argirovski. Këto porosi të kryetarit janë përcjellur me duartrokitje si dhe konkluzioni në lidhje me zgjidhjen e problemit me fondin solidar.

Në pjesën e dytë para të pranishmëve u promovua Monografia "Aktivitetet e pensionistëve për respekt". Për rëndësinë e kësaj veprë historike publicistike ka folur recensenti Aleksandar Dimkovski, kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i gazetës "Nova Makedonija". Pastaj të gjithë të pranishmëve i'u nda nga një kopje të kësaj veprë të rëndësishme.

### Multietniciteti është pasuri

Mbi 350 pensionistë nga njëzet shoqata janë shoqëruar, kanë rinovuar miqësitë dhe kanë krijuar njohje të reja, duke dëshmuar se edhe në kohëra të këtila mund dhe dijnë të jenë njëri me tjetrin, të lënë anash barrierat nacionale dhe ato të tjera dhe së bashku si dhe të shoqërohen të luajnë valle. Ky takim multietnik ishte një argëtim i vërtetë që ka larguar njerëzit e gjeneratës së tretë nga brengat e tyre, duke ua kthyer atyre elanin dhe shëndetin, gëzimin që e shihnin dhe e ndjenin, për t'u ndarë me "mirupafshim në takimin e tetë me radhë multietnik", i cili tash më tradicionalisht po mbahet në Tetovë.

"Lidhja jonë është organizata më masovike joqeveritare në Maqedoni, e cila vepron si apartiake dhe joprofitabile. Vazhdojmë të zgjerojmë miqësinë mes vete, bashkëjetesën dhe çdo gjë tjetër që është pasqyrim i homogenizimit tonë dhe mirëkuptimit të ndërsjellë". Me këto fjalë iu drejtua kryetari i LSHPM, Dragi Argirovski, të pranishmëve, duke shpallur takimin si të hapur. Në këtë takim miqësor me pensionistët mori pjesë edhe Teuta Arifi, kryetarja e Komunës së Tetovës, e cila ju drejtua të pranishmëve. "Prindërit e mi të dashur, ne kemi mirëkuptim të plotë për aktivitetet e juaja, bashkëpunojmë me SHP Tetovë dhe çdoherë ju mbështesim në kufijtë e mundësive tona. Me mënyrën e këtyre të shoqërimit ju ia transmetoni traditën të rinjve, nipërve të juaj, që paraqet një punë të vërtetë fisnike", është shprehur Arifi, e cila si mbështetje ndaj SHP Tetovë premtoi nga buxheti i Tetovës një shumë prej 30.000 denarë. Stojan Sokolovski, kryetari i Kuvendit dhe Shaban Azizi, kryetari i shoqatës, në cilësi të nikoqirit, kanë përshëndetur të pranishmit në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

### SHP Kumanovë

## Ekspursionet njëditor në Qustendil dhe Banjat e Vranjës

Më 9 prill të këtij viti dega e Likovës pranë SHP Kumanovë, në bashkëpunim me Shoqatën e diabetikëve, ka organizuar ekspursion njëditor në Qustendil të Bullgarisë. Për vizitë në Qusetendil u paraqitën dhe morën pjesë 80 pensionistë, në të cilin numër ishin edhe disa pensionistë të cilët vuajnë nga diabeti. Në Qustendil u vizituan disa vende të rëndësishme kulturore dhe historike. Pensionistët me impresione të mëdha u kthyen në Kumanovë. Në kuadër të Programit të pensionistëve nga Kumanova për vitin 2017, mirë të përgatitur nga Komisioni për sport dhe rekreacion, ekspursionet e pensionistëve nga Kumanova vazhduan edhe më 20 prill, kur u vizitua edhe Vranja me Banjat e Vranjës në Serbi. Interesimi i pensionistëve edhe për këtë ekspursion ishte i madh: 200 pensionistë, në mënyrë të organizuar kanë udhëtuar me 4 autobusë për

vizitë në Vranjë dhe Banja të Vranjës, ndërsa pensionistëve të Kumanovës i'u bashkangjitën edhe pensionistët nga komuna e Likovës. Në orët e paradites pensionistët vizituan qytetin e Vranjës, ndërsa pastaj edhe Banjën e Vranjës. Në mënyrë racionale kanë shfrytëzuar kohën edhe për tu futur në banjë në ujin e ngrohtë mineral të kësaj banje të njohur, temperatura e të cilës arrinë edhe deri në 100 gradë Celsius. Pensionistët u kënaqën edhe në shtetije nëpër bukuritë natyrore të rrethinës së këtij vendi turistik. Në shoqërim me pensionistët kishte edhe njohës të historisë së Banjës, si dhe të vendeve tjera të rëndësishme të qytetit të Vranjës dhe Banjës së Vranjës, të cilët me hollësi i kanë njoftuar pensionistët me historinë e pasur dhe të kaluarën e këtij qyteti. Në orët e mbrëmjes pensionistët e Kumanovës dhe Likovës u kthyen në shtëpi.

## Pensionistët nga Dibra mahnitin publikun strugan

Qyteti i bukur afër Lumit Drini i Zi, Struga, ishte nikoqir i revysë rajonale të këngëve dhe valleve popullore të shoqatave të pensionistëve të Rajonit jugperëndimor të Maqedonisë



Në këtë revy e cila është e 15-ta me radhë, kanë marrë pjesë shoqata të pensionistëve nga Dibra dhe Qendra Zhupë, Ohri dhe Dërbëra, Kërçova, Makedonski Brodi, Gostivari dhe nikoqiri Struga. Në sallën e koncerteve të qendrës për kulturë edhe këtë radhë erdhi në pah kënga dhe vallet e bukura të të gjithë atyre që jetojnë në këto hapësira të bukura të vendit tonë, të cilat në mënyrën më të mirë prezantojnë folklorin e pasur. Shoqata Dibrë dhe Qendra Zhupë në këtë revy u prezantua me këngë dhe valle popullore maqedonase dhe shqipe. Grupi i këngëtarëve femra në mënyrën më të mirë ka kënduar përmbledhje të këngëve të vjetra qytetare të asaj ane, të cilat këndohen në ahengje dhe dasma. Pensionisti nga Dibra, Blazhe Petrevski, për ndryshe i njohur për zërin e tij të bukur në opinionin dibran si interperetues i shkëlqyeshëm i këngës popullore dibrane, në shoqërim me grupin e këngëtarëve femra dhe ansamblit

nga Dibra ka kënduar disa këngë të bukura maqedonase. Shfaqja e përfaqësuesve nga Dibra është përshëndetur nga publiku i cili ishte i madh në numër. Dibra edhe kësaj radhe tregoi se di shumë bukur të përfaqësojë folklorin e të gjithë atyre që jetojnë aty. Intelektualja dibrane Sevdije Vojnika, e cila ishte pjesë e grupit të këngëtarëve të SHP Dibrë dhe Qendra Zhupë, ndërsa e cila është e njohur edhe për nga aktivitetet e saja të shumta në shoqatë deklaroi se me kënaqësi ka marrë pjesë në këtë manifestim. "Ne kemi përgatitur disa pika muzikore me këngë të vjetra qytetare nga Dibra dhe të njëjtat i kemi interpretuar në mënyrë të shkëlqyeshme. Ky aktivitet është jashtëzakonisht i rëndësishëm për pensionistet. Ne, pensionistet e Dibrës shoqërohemi,

por gjithashtu me kënaqësi këndojmë dhe vallëzojmë. Dibra ka shumë këngë të bukura të vjetra qytetare me të cilat jami paraqitur në këtë revy në Strugë. Është kënaqësi të konstatohet se çdo vit, grupi i pensionistëve të Dibrës është çdo ditë e më aktive dhe më e mirë", thotë Sevdija. Pensionistët nga Dibra edhe këtë herë në Revynë e Strugës kanë treguar se dinë të prezantojnë me dinjitet si këngët dhe vallet maqedonase, ashtu edhe këngët dhe vallet shqipe nga rajoni i Dibrës. Ata besojnë se do të plasohen mirë dhe do të kenë mundësi të marrin pjesë në Revynë republikane e cila do të mbahet më 06.06.2017 në Shkup, por megjithatë thonë se shoqërimi mes pensionistëve edhe përmes këngës dhe valles është më e rëndësishme se çdo gjë.